



Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 04 Qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 të datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 paragrafi 3, nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/20, datë 05.08.2020) Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.09-Rr të datës 13.08.2020 Prill 2019, dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2026, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK-LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmëria-prona komunale P-71409044-01952-1 në vendin e quajtur “Varosh” me sipërfaqe prej 30m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 189m² e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.1285/2026 pronë në emër të Komunës së Lipjanit, e cila gjendet në rrugën “Shqipëria” në Lipjan.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi prona komunale ipet në shfrytëzim afatshkurtër në afat prej 3 (tri) vitesh për ushtrimin e aktiviteteve biznesore, dhe çmimi fillestar do të jetë prej 4€ (katër euro) për m² në ngarkes mujore, nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe e njëjta është publikuar brenda afatit ligjor në uebfaqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektorit Pronësor-Juridik 1Nr.463/02-70853 datë 30.12.2025 konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092.

Neni 3

Në pronën e cekur në nenin 1 të këtij vendimi nuk lejohet ndërtimi i objekteve të vrazhda apo të forta por vetëm i objekteve të përkohshme në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores të Kuvendit të Komunës së Lipjanit 15Nr.011-5823 datë 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal në bazë të Rregullores QRK Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati i Inspektoratit, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të Rregullores të Kuvendit të Komunës së Lipjanit 15Nr.011-5823 datë 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike

Parcela kadastrale P-71409044-01952-1 siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-vendimi është koncentruar në Zonë banimi/ Zona Urbane Qendrore, parcela në fjalë mund të jetë pjesë e zhvillimeve ndërtimore në zonë duke pasur parasysh interesin publik të komunës e cila mund të shfrytëzohet sipas kushteve të parapara me planet aktuale apo procedurat tjera të së drejtës së shfrytëzimit të pronës komunale siç konstatohet në shkresën e datës 04.03.2022 Numri i vrojtimit.08-034-7910 të Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me qëllim të shfrytëzimit racional të kësaj parcele dhe deri në realizimin e ndërtimeve të banimit kolektiv që do të përfshinë edhe këtë parcelë sipas planit zhvillimor urban, propozohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër për 3 vite, mirëpo nëse ndërtimet realizohen para këtij afati atëherë me kontratë do të përcaktohet mundësia e ndërprerjes edhe para skadimit të aftit prej 3 viteve.

Andaj me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake në një anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim personave fizik dhe juridik pronat e Komunës siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi, kërkojmë nga kuvendi komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

INr. 462/01-17877
Lipjan, më 20.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01952-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1285/2026

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

20.04.2026 - 10:06

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Lipjan / Lipjan / Lyipjan

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01952-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	189			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullosar/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 1/Pasnjak 1 Klase/1st Class Pasture	189

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	/ / /		SHQPËRIA	1/1		